



U.S. Embassy Pristina
Nazim Hikmet 30, Pristina
+381(038)5959-3001

<https://xk.usembassy.gov>

NJOFTIM:

Program Shkëmbimi-Summer Work Travel



(Photo credit: Besfort Sylva, SWT participant from Kosovo)

Ju njoftojmë se me datën 23-Shkurt-2018 në ora 14:30 në Amfiteatrin e Fakultetit të Filologjisë së Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, Shefi i Sektorit Konsullor i Ambasadës Amerikane në Prishtinë z. Brian Corteville, do të mbajë një sesion informativ për të gjithë studentët e intersuar të marrin pjesë në programin e shkëmbimit-Summer Work Travel. Kjo do të jetë një mundësi unike për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të kenë informata të detajuara se si aplikohet? Çka nevojitet? Kushtet që duhet plotësuar? Të drejtat dhe obligimet tuaja? Etj.

Ambasada Amerikane në Prishtinë i inkurajon të gjithë studentët kosovarë që të konsiderojnë pjesëmarrjen në programin e shkëmbimit-Summer Work Travel 2018. Vitin e kaluar përafersisht 500 studentë nga Kosova kanë marrë pjesë në qytete të ndryshme të Amerikës, ku kanë marrë përvoja të dorës së parë të popullit dhe kulturës amerikane, dhe kanë përfituar përvojë të vlefshme të gjuhës angleze dhe përvoja të ndryshme në punë.